



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.364/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Faton Ademi kryesues, Rafet Haxhaj dhe Zyhdi Haziri anëtar, me pjesëmarrjen e Zyrtares së Lartë Ligjore Antigona Murati, duke vendosur përkritazi me ankesën e kandidatit për anëtar të Kuvendit Komunal të Obiliqit, Mentor Berisha, nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega Obiliq për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me 24.10.2017 mori këtë:

## V E N D I M

**HUDHET** si e pa lejuar ankesa e kandidatit për anëtar të Kuvendit Komunal të Obiliqit, Mentor Berisha, nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega në Obiliq, me numër ZL.Anr.364/2017 e datës 23.10.2017, për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017,

## A r s y e t i m

PZAP-i më datën 23.10.2017 ka pranuar një ankesë nga Mentor Berisha, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal Obiliq nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me të cilën pretendon se i janë keqpërdorur votat e tij me të cilën i mungojnë edhe votat e familjarëve në Qendrën e Vendvotimit 1503/01R dhe 1503/02D në Komunën e Obiliqit.

Parashtruesi i ankesës nuk i ka bashkangjitur asnjë provë ankesës, lidhur me rastin në fjalë.

Paneli, pas shqyrtimit paraprak të lejueshmërisë së ankeses gjeti se:

### **Ankesa është e pa lejuar**

Paneli nuk është lëshuar fare në vlerësimin e pretendimeve ankimore, lidhur me shkeljen e pretenduar në ankesë përkritazi me manipulimin e votave në Komunën e Obiliqit, për faktin se shkeljet që ndërlihen me rezultatin e votimit, nga shkelësi i supozuar, duhet të parashtrohen me rastin e shpalljes së rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja, e jo në këtë fazë të procedurës. Në rastin konkret nga KQZ-ja, nuk është marrë vendimi përfundimtar mbi shpalljen e rezultatit përfundimtar, andaj Paneli vendosi që ta hudhë si të parakohshme ankesën e ankuesit. Hudhja e ankesës së ankuesit Mentor Berisha, nuk e paragjykon çështjen dhe

ankuesit nuk i mohohet e drejta që mbi këtë bazë, të paraqes ankesa tjera, pas shpalljes të rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
ZLAnr.364/2017 më datën 24.10.2017.

**Kryesuesi i Panelit**  
**Faton Ademi**



***Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.***